REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 298, 309/20
Datë/Datum. 09.06.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili	*Data e autorizimit të ekspertit* *11.12.2019*	*Data e dorëzimit të raportit* *08.06.2019*	*Nr. i lëndës:* 298-309/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.05.2020, OE "**Graniti**", ka parashtruar ankesë me nr: 298/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës O:"Mobelland", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me inventar në shkollat e arsimit Parauniversitar**", me numër të prokurimit: **19-7223-1-1-1** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –MASHT.

Me datën: 16.05.2020, OE "**Delfina**", ka parashtruar ankesë me nr: 309/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës O:"Mobelland", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me inventar në shkollat e arsimit Parauniversitar**", me numër të prokurimit: **19-7223-1-1-1** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –MASHT.

Data e njoftimit për kontratë 23.09.2020, data e parashikuar e hapjes së ofertave 18.10.2019, data e kërkesës për rishqyrtim 04.05.2020, vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim 08.05.2020.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

PRETENDIMET ANKIMORE (Graniti)

Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt.30.04.2020, ku neve na ka shpallur tenderues të pasuksesshëm, ndërsa e ka rekomanduar për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik Mobelland SH.P.K. & ''ELBASAN ALIDEMT' B.I. me emrin tregtar N.T.P. "METALI".

Ju sqarojmë se ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit që disa herë më radhë, si nga ana e AK-së e po ashtu edhe nga ana e OSHP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

Në dosje të tenderit në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional, ndër të tjera është kërkuar një inxhinier i diplomuar i arkitekturës, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk e

plotëson këtë kërkesë sepse ka ofruar dëshmi për inxhinier të arkitetonikës e jo dëshmi për inxhinier të arkitekturës.

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar si inxhinier z. Liridon Beqiri i diplomuar në master profesional Dizajn Arkitetonik dhe Parametrik, prandaj kjo diplomë është plotësisht në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Prandaj ky operator ekonomik duhet të shpallet i papërgjegjshëm sepse nuk e plotëson kërkesën themelore dhe recidive të dosjes së tenderit.

Fillimisht në FTD është kërkuar decidivisht inxhinier i arkitekturës dhe nuk është lënë hapësira opcionale që të ofrohet edhe dëshmi për master. Për z. Liridon Beqiri i diplomuar në master profesional Dizajn Arkitetonik dhe Parametrik nuk është ofruar asnjë dëshmi se ka kualifikim inxhinier i diplomuar i arkitekturës si studime themelore bazë dhe nuk e dimë se çtarë kualifikimi ka, ndërsa sa i përket ofrimit të dëshmisë për master, kjo dëshmi nuk është përcaktuar në dosje mirëpo edhe po të ishte përcaktuar si kualifikim në master të arkitekturës atëherë OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën sepse ka ofruar dëshmi për kualifikim në master profesional Dizajn Arkitetonik dhe Parametrik që nuk përkon me kërkesën në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Pastaj OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë dëshmi për nostrifikim të diplomës së çfarë titulli i njihet këtij personi, ndërsa për inxhinierin tjetër z. Heset Shala ka ofruar diplomën e studimeve themelore dhe master e po ashtu ka ofruar edhe vendimin për nostrifikim të diplomës së masterit, e që realisht është dashtë të ofrohet nostrifikimi edhe për diplomën e z. Liridon Beqiri, sepse pa diplomë të nostrifikuar nuk lejohet të punohet në Kosovë dhe nuk njihet titulli sepse është i dyshimtë.

Ne kemi pasur qasje në dokumente tek autoriteti kontraktues dhe ndër dëshmitë që i kemi marr ka qenë edhe emaili i znj.Arbërita Tafilaj i dt.23.01.2020 e cila i është drjetuar znj. Kumrije Gagica Udhëheqëse në Qendrën Kombëtare për njohje dhe informim Akademik për të sqaruar dhe interpretuar se titulli Dizajn Arkitetonik dhe Parametrik me titullin inxhinier i diplomuar i arkitekturës a është i barazvlefshëm. Poashtu e kemi marr edhe emailin me përgjigje të kthyer me dt.23.01.2020 nga znj. Kumrije Gagica-Udhëheqëse në Qendrën Kombëtare për njohje dhe informim Akademik e cila ka sqaruar se këta dy tituj nuk janë ekuivalentë-të barazvlefshëm. Prandaj edhe ju duhet besuar këtyre institucioneve kompetente dhe duhet vlerësuar ashtu siç e kanë sqaruar Qendra Kombëtare për njohje dhe informim Akademik.

Bashkangjitur keni emailat me komunikime zyrtare ndërmjet zyrës së prokurimit me Qendrën Kombëtare për njohje dhe informim Akademik.

Ju sqarojmë se vendimi i OSHP-së Nr.896-19 i dt.31.01.2020 ku ka konstatuar se nuk është kërkuar dëshmi e kërkuar dokumentare në lidhje me inxhinierin e arkitekturës është konstatim absurd dhe jo profesional totalisht sepse në momentin që kërkohet inxhinier i arkitekturës kuptohet që duhet të dëshmohet me diplomë se personi i prezantuar si inxhinier i arkitekturës e ka kualifikimin në fjalë sepse nuk mund të dëshmohet ndryshe një kërkesë e tillë. Prandaj autoriteti kontraktues është dashur të bazohet në kërkesat e tyre të vendosura në dosje të tenderit e jo në vendime apo konstatime të pabazuara në fakte dhe argumente. Gjithashtu kërkesën në lidhje me inxhinierin e arkitekturës nuk mund ta plotësojë asnjë kualifikim tjetër, përveç diplomës së inxhinierit të arkitekturës, sepse çfarëdo pranimi tjetër

që bëhet është shmangie nga kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe veprohet në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së sepse aty qartë shkruan "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderi ".

Për shkak se kërkesa është e qartë se duhet dëshmuar me diplomë edhe ne operatorët ekonomik i kemi ofruar dëshmi diplomat, sikurse ne e po ashtu edhe OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar dëshmitë që i ka pasur në dispozicion edhe pse nuk janë adekuate.

Po ashtu Certifikata Nr. Fiskal i partnerit të konzorciumit ELBASAN ALIDEMI B.I është e vjetër e vitit 2009, andaj kjo nuk duhet të merret si e vlefshme.

Gjithashtu OE i rekomanduar regjistrimin e firmës ELBASAN ALIDEMI B.I e ka me dt. 07.03.2019 andaj kontratat dhe referencat e paraqitura nga ana e OE të rekomanduar para kësaj date nuk mund të merren parasysh sepse janë kontrata të një entiteti tjetër juridik.

Po ashtu edhe Mobelland shpk regjistrimin e tij si OE e ka me 03.04.2018 dhe gjithashtu kontratat dhe referencat e OE të rekomanduar për kontratë nuk duhen të merren të vlefshme para kësaj date, sepse realisht janë dëshmi-kontrata të një entiteti tjetër juridik.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë tek Formulari i dorëzimit te tenderit faqe nr.-3 është shënuar çmimi vetëm me numra 505.226.00, ndërsa me fjalë jo.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse tek Formulari i dorëzimit të tenderit faqe nr.-3 nuk është shënuar emri i Partnerit të Konzorciumit si dhe udhëheqësi i konzorciumit

Edhe dokumentacioni i vulosur nga O.E Elbasan Alidemi B.I është i vulosur vetëm me vulën e vjetër NTP e cila nuk vlen dhe nuk është valide pasi tani më është Biznes Individual siç figuron në ARBK, prandaj nuk duhet të merren parasysh këto dëshmi të ofruar nga ky operator ekonomik.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse tek afati i liferimit figuron vetëm nënshkrimi nga njeri anëtar i konzorciumit, ndërsa është shumë e logjikshme që duhet të jetë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e konzorciumit sepse të gjitha janë partner në këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu edhe garancioni është i nënshkruar vetëm nga njeri anëtar i konzorciumit.

Gjithashtu edhe katalogu me specifika i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë është i një firme tjetër sepse shihet qartë ku shënon vetëm - mobel - ndërsa është paraqitur si e OE te rekomanduar për kontratë, gjithashtu nuk shihet qartë dhe nuk ka as vula e as nënshkrime.

Gjithashtu edhe kontratat e punës të Inxhinierëve nuk janë valide për Liridon Beqiri-Dizajn Arkitektonik dhe Parametrik si dhe Heset Shala-Përpunim i Drurit sepse nëse shikohet kontratat e inxhinierëve të lartpërmendur tek Neni 7 shihet qartë se kontrata hyn në fuqi me

rastin e nënshkrimit te kontratës me Ministrin e Arsimit.

Ndërsa në D.T 8.1 & 8.2 tek Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar se Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se mesatarja e të punësuarve në çdo vit duhet të jetë minimum 20 punëtor në mesin e tyre një inxhinier i diplomuar arkitekturës, dhe Inxhinieri industrisë së drurit.

Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi konkrete dhe të faktuara se mesataren e punëtorëve e ka për çdo vit minimum 20 punëtorë, sepse e ka ofruar vetëm një të ashtuquajtur raport e ku shkruan vetëm me ljalë se p.sh për vitin 2016 i ka 11 punëtorë, mirëpo nuk është ofruar asnjë dëshmi konkrete nga ATK apo trusti se janë paguar tatime dhe kontribute për punëtorët. Po ashtu në kërkesë thuhet duke përfshirë edhe një inxhinier të arkitekturës dhe një Inxhinier të industrisë së drurit, ndërsa nuk ka asnjë dëshmi se gjatë këtyre tri viteve të kaluara OE i rekomanduar për kontratë ka pas të angazhuar këta inxhinier sepse në kontratat e me këta dy persona të prezantuar me dosje të tenderit, shihet se janë kontrata vetëm për këtë projekt për shërbime të veçanta, pra nuk ka dëshmi se këta persona kanë qenë të punësuar edhe gjatë viteve të kaluara, e për të hyrë edhe në llogaritjen e numrit

mesatar të punëtorëve.

Prandaj edhe për këtë arsye OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka arrit të dëshmojë se ka pasur të përfshirë gjatë tri viteve të fundit një inxhinier i diplomuar arkitekturës, dhe Inxhinieri industrisë së drurit.
Si është e mundur qe te rekomandohet për kontrate me vlere te madhe një konzorcium qe veç dy para kontrata te punëtorëve i prezanton, ndërsa ne dyshojmë qe ky konzorcium nuk ka asnjë punëtor te punësuar ose i ka të pa deklaruar qe nuk paguajnë asnjë tatim shtetit tonë.

Nuk është dëshmi vetëm deklarata e thatë se ne këtë vit i kemi pas kaq punëtorë, por juridikisht dhe logjikisht duhet ofruar dëshmi konkretet Lista nga ATK, ose Lista e punëtoreve qe marrin rroga nga Banka, me Kontratat e punëtoreve, prandaj nuk duhet ti merrni parasysh këto deklarata të kota dhe të shpallet i papërgjegjshëm OE i rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu tek lista e çmimeve nuk shihen as artikujt dhe as specifikacioni teknik të cilat nuk dihen se çka janë, andaj ne dyshojmë se është e vendosur qëllimisht për manipulime gjithashtu edhe disa çmime nuk shihen fare. Po ashtu lista e çmimeve nuk është as e nënshkruar dhe as e vulosur nga asnjëri operator ekonomik.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën në lidhje me Listën e Kontratave me Reterenca ku është kërkuar 1,500,000.00, kurse këta te dy operator ekonomik në konzorcium as përafërsisht nuk e kanë plotësuar këtë kërkesë, madje edhe nëse shkelet ligji dhe ju pranohen referencat me firma te vjetra përsëri nuk arrijnë vlerën e kërkuar, prandaj si konzorcium i kanë 1,115,60.00 euro. Kjo dëshmohet me Referencat qe i kanë paraqit vet këta dy operator ekonomik.
Ka kontrata të cilat janë nënshkruar dhe realizuar në vitet 2013, 2014, 2015 të cilat nuk duhet të merren parasysh. Po ashtu ka referenca që nuk kanë datë, vulë e as nënshkrim, disa as vlerë te çmimit, prandaj nuk mund të merren parasysh as këto dëshmi.
Më poshtë janë sqarimet në tabelë, që ne i kemi bërë dhe përllogaritur se cilat kontrata janë

valide, e cilat jo, të dy anëtarëve të konzorciumit të rekomanduar për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse është kërkuar deklarata e Prodhuesit, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë i ka mashtruar se i prodhojnë vetë këta artikuj:
- Karrikat rrotative për zyre te administratës nuk prodhohen ne Kosove (kjo është mashtrim)
- Ky konzorcium nuk prodhon Ormana metalik te plastifikuar me 2 dyer, 5 dyer, 8 dyer, 12 dyer etj

Prandaj kërkojmë që të verifikohen këto pretendime tona ankimore, sepse ne më këto pretendime, jo vetëm që po i parashtrojmë në OSHP, por do ti paraqesim edhe në organet kompetente për tu verifikuar këto deklarata.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se tek përshkrimi i çmimeve, disa nga çmimet për njësi të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë janë të padukshme gjë që na bën të dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë është munduar të manipulojë me çmime. Andaj AK-ja është dashur të kërkoj sqarime shtesë në lidhje me këtë pikë, gjithashtu të hiqen edhe dyshimet tona në lidhje më këtë pretendim tonin. Andaj AK-ja është dashur ta shpall si tenderues të papërgjegjshëm OE të cilin e ka rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu AK-ja në njoftimin mbi vendimin e dt. 18.11.2019, e ka konstatuar se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe gjithashtu e ka shpjeguar shumë qartë se OE të cilin e ka rekomanduar për kontratë në njoftimin mbi vendimin e fundit se është i papërgjegjshëm. Andaj vendimi i fundit po bie ndesh me vendimin e lartpërmendur të AK-së, pra AK-ja po bie në kundërshtim me vendimin e saj, gjë që tregon se ne si OE i përgjegjshëm po diskriminohemi në këtë aktivitet të prokurimit.

Ne me dt. 08.05.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim dhe gjithashtu nuk është shqyrtuar asnjë pretendim ankimor, rast ky që tregon qartë se ne po diskriminohemi nga ana e autoritetit kontraktues, sepse AK-ja në njoftimin mbi vendimin e saj e ka cekur se vetëm i ka zbatuar rekomandimet e vendimit të OSHP-së nr.896/19 të dt.31.01.2020. AK-ja është e obliguar që ti zbatojë dispozitat e LPP-së sepse vendimi për rivlerësim të këtij aktiviteti të prokurimit, e ka kthyer në pikën zero këtë aktivitet të prokurimit, prandaj rivlerësimi duhet të bëhet që nga fillimi sepse me vetë faktin se lënda është kthyer në rivlerësim kuptohet që duhet të bëhet rivlerësimi konform dispozitave të LPP-së dhe sipas kërkesave të FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse është

rekomanduar për kontratë OE i papërgjegjshëm.

Gjithashtu ju si AK nuk e keni respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e PTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Gjithashtu ju si autoritet kontraktues nuk e keni pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"Graniti" SH.P.K**

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente

PRETENDIMET ANKIMORE (Delfina)

Pretendimi 1.

Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes fitues të një grupi të OE të papcrgjeshëm nga aspekti i kerkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë për ketë aktivitet te prokurimit ka bere shkeljen e I.PP ne fuqi per arsye se nuk ka pasur të drcjtë të shpërblej me kontratë grupin i cili nuk i ka plotësuar kerkesat e dosjes së stenderit dhe te njoftimit per kontrate të bërë nga AK.

Kerkesat që nuk janë plotesuar janë :

1. QERTIFIKATË EN. 1729-1, 2015 EN 1729-2 2012+Al 2015 -Kjo eshte kerkesa e AK e cekur ne dosjen e tenderit e cila qertifikate eshte vetem per **KARRIG SHKOLLORE GRUPI I KATERT** (parauniversitar) - OE i shpallur fitues nga AK nuk e ka plotesuar kete kerkese.
2. QERTIFIKATË EN. 1729-1 2015 EN1729-2 2012+A1 2015 -Kjo eshte kerkesa e AK e cekur ne dosjen e tenderit e cila qertifikate eshte vetem per **BANKË SHKOLLORE GRUPI I KATERT** (parauniversitar) - OE i shpallur fitues nga AK nuk e ka plotesuar

kete kerkese.

Sqarim : OE i shpallur fitues nga AK i ka ofruar dy certifikata të cilat sikur të ishin në një certifikat të vetme do të ishin për karrig ose për bankë . KËTO CERITIFKATA NLJK I PLOTËSOJN KËRKESAT E AK-së.

Qertifikatat duliet te jenë sikur modeli qe ne po ia bashkangjesim AKESES sonë (qertifikatat tona)

dhe keto qertifikata e plotesojn kerkesen e AK-se.

Pretendimi 2.

Në përshkrimin e çmimeve (paramasë), disa nga çmimet për njësi, janë të padukshme PROVE :

LETER STANDARDE PER TENDERUESIN E ELEMINUAR e dates 18.11.2019.

1. ÇMIMI I PADUKSIIEM ËSHTË NË POZICIONIN ni.30

Dollap me rrota me 3 sirtar / administrate , bibloteke , dhoma e mesuesve .

Te ky pozicion çmimi per njësi është i padukshëm (Sasia eshte eope 36 çmimi per njesi i padukshem ndersa totali është 1080).

Për këtë pozicion AK nuk mund te vendos se eshte i plotesuar siq duhet per arsye se nuk shifet.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë ne si grup i OE kerkojm : nga paneli shqyrtues i OSHP-së që ankesen tonë ta e pranoj si të bazuar dhe këtë procedur ta c kthcj në rivlcrsiin në mcnyrë qc AK të kctë mundcsi të i clcniinoj shkeljet e bera dhe ne te shpallemi fitues të ketij aktiviteti të prokurimit.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmëri së profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin,e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2. Regjistrimi i numrit fiskal 3. Regjistrimi i TVSH-se 4.EN.1729-1 2015 EN1729-2 2012+A1 2015. 5.EN.1729-1 2015.EN1729-2 2012+A1 2015 6. Katalogun nga prodhuesi 7. Autorizimi nga prodhuesi për OE, 8. Garancioni nga prodhuesi 24 muaj	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të Operatorit Ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit); 2 Kopja e numrit fiskal 3. Kopja e certifikatës së TVSH-se 4. EN.1729-1 2015 EN1729-2 2012+A1 2015. 5. EN.1729-1 2015.EN1729-2 2012+A1 2015 6. Katalogun nga prodhuesi 7. Autorizimi nga prodhuesi për OE, 8. Garancioni nga prodhuesi 24 muaj
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar Raporti financiar për tri vitet e fundit duhet të jetë së paku 2.000,000.00 €	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Vërtetimi origjinal ose i noterizuar nga ndonjë bankë

financiare			
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional Kërkesa . Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se mesatarja e të punësuarve në qdo vit duhet të jetë minimum 20 punëtor në mesin e tyre nje inxhinier i diplomuar arkitekturës,Inxhinieri industrise se drurit Kërkesa :Furnizime të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të (Njoftimit për Kontrat),e vërtetuar nga OE,ku përfshihen titujt e projekteve,numri,data e kontraktimit dhe vlera,minimale duhet të jetë 1.500.000,00€	*Dëshmia e kërkuar dokumentar :* Dëshmia: Lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave për furnizim në vlerë totale 1.500.000.00 €. Të gjitha referencat të furnizimeve të ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftmit për kontratë Dëshmia: Raport nga OE, për fuqin mesatare të punëtore për tri vitet e fundit.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "GRANITI"

Përgjigje në Pretendimi nr.1
Lidhur me pretendimin e parë ankimorë, për inxhinierin e arkitekturës vlerësojmë se kjo është çështje e gjykyuar e cila është vendosur me vendim të OSHP-së nr.896/19.

Përgjigje në Pretendimi nr.2
Lidhur me pretendimin ankimorë se certifikata e numrit fiskal e partnerit Elbasan Alidemi është e vitit 2009 dhe për këtë arsye di njëjti duhet eliminuar, vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar, dhe se kjo nuk paraqet arsye për eliminim të OE.

Përgjigje në Pretendimin nr.3
Lidhur me pretendimin ankimorë se nuk duhen merren parasyshë kontratat e OE fitues, me arsye se i njëjti ëhtë regjistruar si biznes në vitin 2018 përkatësisht 2019, vlerësojmë se edhe ky pretendim ankimorë është i pabazuar sepse këto kompani janë të regjistruara si biznese shum më herët, dhe ndryshimi i certifikatës së regjistrimit është vazhdimësi e njejtave biznese. Konkretisht OE Mobelland është themeluar në vitin 2004 ndërsa OE Elbasan Alidemi emri regtar Metali në vitin 2000, andaj vlerësojmë se gjitha kontratat e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë brenda periudhës kohore të përcaktuar në dosje nuk mund të rerfuzohen.

Përgjigje në Pretendimin nr.4
Lidhur me pretendimin e OE se nuk ka ofruar cmimin me fjalë, vlerësojmë se kjo nuk mund të merret si arsye për eliminim të OE , andaj pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.5
Pretendimi ankimorë se OE Elbasan Alidemi ka përdor vulë të vjetër, konsiderojmë se as kjo nuk është arsye për eliminim të OE.

Përgjigje në Pretendimin nr.6
Lidhur me pretendimin se te afati liferimit ka nënshkruar njëri anëtar, sqarojmë se se afati liferimit është vulosur nga lideri i grupit, i cili me marrveshje bartë të drejtën për nënshkrim dhe vulosje të gjitha dokumenteve që nga dalin nga kjo proceudrë e prokurimit, andaj kosniderojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.7
Lidhur me pretendimin ankmorë se kompania Mobelland ka ofruar një katalog që nuk është i saj, dhe se katalogu i ofruar shënon vetëm Mobel, sqarojmë se katalogu të cilin e kontëston OE ankues, vërtetë është kopje e kualtietit të dobët ku në disa vende në shikim të parë nuk lexohet komplet emri Mobelland, mirëpo nëse shikojmë me kujdes, shihet se katalogu është i firmës Mobelland, dhe pjesa "Land" është më vështirë e lexueshme për sigurisht për shkak të dallimit të ngjyrave në logo të kësaj kompanie, ku pjesa Land e cila është e kuqe në printim bardh e zi është më vështirë e lexueshme, me gjithatë shihet se nuk kemi të bëjmë me katalog të ndonjë kompanie tjetër. Andaj vlerësojmë se edhe ky pretendim ankimorë është i pabazuar.

Provë: oferta e OE ankues – katalogu i gjetur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin nr.8
Lidhur me pretendimin anjkiomorë se inxhinierët L.Beqiri dhe H.Shala nuk janë punëtor të OE dhe se nuk kanë kontrata pune me OE, sqarojmë se OE ka ofruar kontrata pune me kohë caktuar për dy këta persona.

Përgjigje në Pretendimin nr.9
Lidhur me pretendimin ankimorë se OE nuk ka mesataren prej 20 punëtor në vit dhe se nuk e ka dëshmuar me vërtetim të ATK-së, sqarojmë se kërkesë e dosjes nuk ka qenë vërtetim i ATK-së por raport prej OE, dhe sipas drklaratave-raporteve të OE dë ky kompnitë së bashku arrihjnë mesataren prej 20 punëtor në vit, andaj kosniderojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.9
Lidhur me pretendimin ankimorë se te lista cmimeve nuk nuk shihet specifikacioni teknik dhe se nuk është e

vulosur dhe nënshkruar, sqarojmë se me gjithë se kualtiiteti i kopjes është i dobët, lista dhe specifikacionet me gjithë atë janë të lexueshme, e po ashtu është e nënshkruar në faqe të fundit, me gjithë në prokurim elektronik nuk do të paraqiste problem.

Përgjigje në Pretendimin nr.10
Lidhur me pretendimin ankimorë se OE nuk i ka 1.5 milion euro kontrata për tri vitet e shkuara, sqarojmë se sipas listave të ofruara nga vet OE i rekomanduar për kontratë, edhe pasë eliminimit të kontratave që janë realizuar më herët se periudha e kërkaur në dosje, dhe pas eliminimit të kontratave të cilat janë ende në realizim e sipër, OE i rekomanduar për kontratë prap arrinë dhe tejkalon vlerën prej 1.5 muilion sipas kërkesave të dosjes, dhe në rast se AK ka pas dyshim për vgërtetësinë e ndonjë kontratë kan mundur të kërkojn sqarime prej OE, andaj vlreësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.11
Lidhur me pretendimin ankimorë se OE nuk ka deklaratë të prodhuesit ndërsa nuk është prodhues i karrikave rotative dhe i ormanave metalik, sqartojmë se që dy partnerët janë të regjistruar si prodhues të karrigave apo inventarit të ndryshëm dhe eksperti sqhyrtues nuk ka kapacitet teknik të konstatoj një pretendim të tillë ankimorë.

Përgjigje në Pretendimin nr.12
Lidhur me pretendimin ankimorë se disa cmime të OE të rekomanduar për kontratë nuk janë të dukshme, vlerësojmë se kjo është qështje e gjykuar me vendim të OSHP-së nr.896/20, dhe me gjithë se kualtieti i kopjes është i dobës me gjithatë gjitha cmimet e OE jan të lexueshme.

Përgjigje në Pretendimin nr.13
Lidhur me pretendimin ankimorë se nuk ka dhënë "*asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim*", vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar, me gjithë këtë kthimi i lëndës në rivlerësim mbi bazën e këtij pretendimi ankimorë nuk do kishtë ndikim në rezultat final të vlerësimit të ofertave.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "DELFINA"

Përgjigje në Pretendimi nr.1
Lidhur me pretendimin e parë ankimorë, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka për plotësuar kërkesën për QERTIFIKATË EN. 1729-1, 2015 EN 1729-2 2012+Al 2015, sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofrarur së pari certifikatën EN.1729-1:2015 si dhe certifikatën EN 1729-2 2012+Al 2015, certifkata këto për prodhim të dyshekëve, ulëseve për një, dy dhe tre persona si dhe për karrige rotative. Me qenë se nuk ka pas kërkesë decidive nga AK se kërto certifikata duhet të jenë për tavolina vlerësojmë certifikata ofruar është në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2
Lidhur me pretendimin ankimorë për cmime të padukshme, vlerësojmë se kjo është qështje e gjykar me vendim të OSHP-së nr.896/19 , dhe me gjithë se kualtieti i kopjes është i dobët, me gjithë këtë cmimet e OE të rekomanduar janë të dukshme.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues Graniti të të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ankesa e OE Delfina të refuzohet e pabazuar, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK-sëpër dhënie të kontratës.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MASHT.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - Graniti
- OE ankues - Delfina